



KPMG Albania Shpk Dega në Kosovë
Rruga "Sulejman Vokshi"
Nr.14
Prishtinë ,Kosovë

Telefon +381 (38)246771
Faks +381(38)246772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

RAPORT AUDITIMI

MBI PASQYRAT FINANCIARE
TË KOMUNËS KAÇANIK
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtine, Korrik 2013

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|-----------|
| PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME..... | 3 |
| FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT..... | 4 |
| I. OPINIONI I AUDITIMIT | 5 |
| II. PASQYRAT FINANCIARE - PAJTUESHMËRIA ME KORNIZËN RAPORTUESE | 8 |
| II.1 PAJTUESHMËRIA ME KORNIZËN RAPORTUESE | 8 |
| II.2 CILËSIA DHE SAKTËSIA E INFORMACIONEV TË PARAQITURA NË PASQYRAT VJETORE FINANCIARE | 8 |
| III. GJETJET E VITIT TË KALUAR | 10 |
| IV. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI..... | 11 |
| IV.1 HYRJE | 11 |
| IV.2 PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI BUXHETOR | 11 |
| IV.3 RAPORTIMIT AKTUAL DHE AFATET KOHORE NË PROCESIN E PËRGJITHSHËM BUXHETOR..... | 12 |
| IV.4 TË HYRAT (DUKE PËRFSHIRË ATO VETJAKE)..... | 12 |
| IV.5 SHPENZIMET | 13 |
| IV.6 ASETET | 15 |
| IV.7 TRAJTIMI I BORXHEVE..... | 16 |
| V. SISTEMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM | 17 |
| V.1 SISTEMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM | 17 |
| V.2 AUDITIMI I BRENDSHËM | 17 |
| VI. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM MBI MENAXHIMIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT.... | 18 |
| SHTOJCË 1 LLOJE TE NDRYSHME TË OPINIONEVE TE AUDITIMIT TE ZBATUARA NGA KPMG NE RAPORTIN VJETOR TE AUDITIMIT 2012 | 19 |
| SHTOJCË 2: REKOMANDIMET NGA VITI PARAPRAK | 21 |
| SHTOJCË 3 KOMENTET E MENAXHMENTIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT DHE PËRGJIGJJA E KPMG-SË..... | 23 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

KPMG ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare ("PVF") të Komunës së Kaçanikut ("Komuna"), në emër të Zyrës së Auditorit Përgjithshëm, për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2012.

Ky raport përmbledh çështjet kryesore të identifikuar nga auditimi ynë. Ne duam të falënderojmë Kryetarin e Komunes dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne gjykojmë se ishin të nevojshme për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare.

Fokusi ynë është përqendruar mbi mjaftueshmërinë e shumave dhe shpalosjeve në PVF për të dhënë një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi. Procedurat tona përfshijnë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve e procedurave të kontabilitetit deri në masën që gjykojmë se nevojshme për përgatitjen efektive të auditimit. Gjetjet tona nuk duhet të konsiderohen si nje përmbledhje gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që ekzistojnë, ose e të gjitha përmirësimeve të cilat mund t'iu bëhen sistemeve dhe procedurave ekzistuese.

Konkluzioni ynë përmbledhës për Menaxhmentin e Komunës paraqitet në pikën VI të këtij raporti.

Kontrolli i Brendshëm

Gjatë auditimit ne kemi identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto mangësi janë përshkruar më hollësisht brenda këtij raporti.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme të Komunës nuk është percaktuar dhe nuk është implementuar sic duhet për të eliminuar dobësitë e dukshme.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe i kontrolleve të brendshme, ne i rekomandojmë Komunës që të sigurojë:

- Një listë e plotë e pronave, ndërtesave dhe pajisjeve të Komunës;
- Vendosja e një sistemi automatik të faturimit për të gjitha llojet e taksave;
- Marrjen e masave për të rritur mbledhjen e të hyrave nga taksat e ndryshme; dhe
- Pajtueshmëri të plotë me Ligjin nr.04/L-042 "Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë" (i ndryshuar)

Menaxhmentit të Komunës i është ofruar mundësia të japin komentet për gjetjet tona të prezantuara në këtë raport. Menaxhmenti ka rënë dakord të bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar të gjitha rekomandimet tona.

Referojuni Shtojcës 3 për komentet e menaxhmentit në rekomandimet tona dhe përgjigjen tonë ndaj tyre.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012.

Është përgjegjësi e Komunes të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Rregullës Financiare 07/2011 dhe në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

KPMG, në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor për pasqyrat financiare të Komunes për vitin e mbyllur më 31 dhjetor.

Auditimi përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe jep siguri mbi:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Përshtatshmërinë e e kontrolleve të brendshme dhe të funksionit të auditimit të brendshme; dhe
- Çështje të tjera me rëndësi të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim::

- Krahasimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunes në raport me buxhetin e miratuar për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2012;
- Përcaktimin nëse Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNSKP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullit Financiar nr. 07/2011;
- Vendosjen e nje niveli materialiteti, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Perdorimin e kombinimit të gjykimeve dhe zgjedhjeve rastesore për perzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kryerjen e testeve me detaje mbi transaksionet financiare; dhe
- Mbeshtetjen në një kombinim të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimit të dokumentave dhe verifikimit fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2012.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës, ONIAS përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1 që përfshin një ekstrakt nga ISSAI 400.

I. Opinioni i Auditimit

Për Komunën e Kaçanikut

Prishtinë, 2 korrik 2013

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Komunës Kaçanik ("Komuna"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012, një krahasim të buxhetit me shumat aktuale, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe shënimeve të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmenti për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') – *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Rregullën Financiare Nr. 07/2011 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*. Kjo përgjegjësi përfshin hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me Organizata Ndërkombëtare e Instruksioneve Supreme të Auditimit (ONISA) Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur deri te një siguri e arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë së evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Baza për Opinion me Rezervë

Gjashtë dosje të prokurimit me shumë totale të kontraktuar prej 336 mijë Euro dhe vlerë totale të paguar deri në fund të vitit 2012 prej 299 mijë Euro, janë nën hetime nga zyra e prokurorit publik dhe nuk na janë vënë në dispozicion. Ne nuk jemi në dijeni për arsyet dhe statusin e këtyre hetimeve, si dhe për rezultatin e mundshëm final.

Opinionit me Rezervë

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të përshkruar në paragrafin e bazës për opinionit me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Rregullin Financiar Nr. 07/2011 *Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore*.

Theksim i çështjes

Pa kualifikuar më tej opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen si në vijim:

- Shuma totale e shpalosur në Nenin 16 'Shpalosja e pasurive' është 80 mijë Euro më e lartë se në regjistrin e pronës të siguruar nga Komuna. Ky dallim nuk është shpjeguar nga ana e Komunës. Për më tepër, për pasuritë të caktuara, mund të ketë paqartësi në lidhje me të drejtat e pronësive në mes të Komunës dhe Agjensive të ndryshme të tjera të Qeverisë së Kosovës, dhe mungesë të dokumentacionit mbështetës të pronësisë. Për më tepër, për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës për matjen e një pjese të konsiderueshme të pasurive, Komuna ka kërkuar të masë objekte të tilla në vlerën e drejtë në bazë të një vlerësimi të kryer nga nje komitet i brendshëm. Vlerësimi përfshinte vetëm ndërtesat kryesore komunale dhe jo të gjitha pronat, ndërtesat dhe pajisjet ishin përfshirë.
- Informacioni krahasues per pagesat nga palët e treta në vlerë prej 811 mijë Euro për vitin 2010 i paraqitur në Shënimin 12 "Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave" është në vlerë më të lartë për 484 mijë Euro nga totali 327 mijë Euro, i paraqitur në pasqyrat financiare të audituara për vitin 2011.

Rishikimi i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe shtirja e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me ato të hartuara për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare. Këto parime kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë rishikimin me qëllim që të marrim një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare janë në të gjithë aspektet materiale në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie

Ne besojmë se evidenca që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

- 1 Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Meqenese Free Balance nuk përdoret për të regjistruar pagesat nga palët e treta dhe faturat e papaguara, nuk mund të përdoret vetëm që të prodhojë pasqyra të plota financiare.

- 2 Meqenëse Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, ekziston një pasiguri lidhur me plotësinë e të arkëtueshmeve dhe të hyrave që Komuna mund të fitojë, dhe aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në kohë.
- 3 Ne kemi identifikuar një numër mospërputhshjesh me Ligjin Nr. 04L-042 “Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë” (i ndryshuar). Mospërputhje të tilla janë të lidhura me procedurat e kërkuara të cilat Komuna nuk i ka kryer dhe dokumentuar.
- 4 Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa çështje të vogla ligjore dhe mund të kërkoen flukse dalëse monetare të ardhshme në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontigjente.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
Sulejman Vokshi, Nr. 14
Prishtinë
Kosovë

II. Pasqyrat financiare - Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare ("PVF") konsideron si pajtueshmërinë me kornizën raportuese edhe cilësinë dhe saktësinë e informacioneve të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu konsiderojmë Deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PVF draft dorëzohet në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare përfshin një numër pohimesh për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit të pasqyrave financiare. Një pjese e pikave në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informacionet relevante janë paraqitur për t'u siguruar se ndërmarrja e një auditimi gjithëpërfshirës është e mundur.

II.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Kërkesat nga LMFPP Nr. 03/L-048 dhe Rregulla Financiare 07/2011.

- Përveç siç përmendet në bazën për opinionin me rezervë Komuna ka përgatitur pasqyrat financiare në pajtueshmëri me Regullën Financiare nr. 07/2011;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i njësië së audituar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 31 Janar 2013 dhe janë dorëzuar tek Ministria e Financave ("MF");
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në Ministrinë e Financave në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek MF gjatë vitit 2012.

II.2 Cilësia dhe saktësia e informacionev të paraqitura në Pasqyrat Vjetore Financiare

Gjetjet

- Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Gjithsesi, meqenese Free Balance nuk përdoret për të regjistruar pagesat nga palët e treta, ose faturat e papaguara, nuk mund të përdoret vetëm që të prodhojë pasqyra të plota financiare per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012.
- Gjashtë dosje të prokurimit me shumë totale të kontraktuar prej 336 mijë Euro dhe vlerë totale të paguar deri në fund të vitit 2012 prej 299 mijë Euro, janë nën hetime nga zyra e prokurorit publik dhe nuk na janë dhënë neve. Ne nuk jemi në dijeni për arsyet dhe statusin e atyre hetimeve, si dhe për rezultatin e mundshëm final.
- Shuma totale e shpalosur në Shenimin 30 "Përmbledhja e asetëve kapitale jo-financiare (me vlerë mbi 1,000 Euro) nën posedim të buxhetit të organizatës" është 80 mijë Eur më e lartë se regjistri i pronës, impianteve dhe pajisjeve që na është dhënë nga Komuna. Ndryshimi nuk është shpjeguar nga Komuna.
- Realizimi i të hyrave vetanake dhe donacioneve të paraqitura në Nenin 13 "Raporti i ekzekutimit të buxhetit" nuk barazon me raportet e Free Balance.

- Shënimi 12 “Pagesat tjera” shpalos informacione për financimet e Komunës nga palët e treta, të cilat janë shpalosur gjithashtu edhe në Shenimin 6 “Pranime tjera”, në vend të informacionit për kategoritë e shpenzimeve të financuara nga palët e treta, sic kërkohet.
- Informatat krahasuese për pagesat nga palët e treta në vlerë prej 811 mijë Euro për vitin 2010, të paraqitura në Nenin 12 “Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme” është për 484 mijë Euro më e lartë se totali prej 327 mijë i paraqitur në pasqyrat financiare të audituara për vitin 2011.
- Shënimi 29 “Detyrimet kontigjente” nuk është kompletuar.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunes të sigurohet se përgatitja e pasqyrave financiare duhet të përfshijë procedura dhe mjete të projektuara për t'u siguruar që informatat e kerkuara janë të regjistruara, të procesuara, të përmbledhura dhe të raportuara në mënyrë të pershtatshme në pasqyra financiare

III. Gjetjet e vitit të kaluar

Raporti ynë mbi PVF për vitin 2011 përfshiu rekomandimet e mëposhtme kryesore që mbeten të adresohen, si në vijim:

- Një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave duhet të adoptohet dhe duhet të ndërmerren masa që të rriten inkasimet (mbledhjet) nga taksat e ndryshme;
- Regjistri i të arkëtueshmeve duhet të përditësohet sipas pagesave të bëra në lidhje me faturat e lëshuara nga Komuna dhe trajtimi për mbledhjet e parasë së gatshme;
- Burime shtesë (të vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar) duhet të përfshihen në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës;
- Përmirësimet duhet të implementohen për shpenzimet si dhe pagat dhe mëditjet;
- Të gjitha përpjekjet duhet të bëhen për të bërë pagesat brenda vitit.

Dështimi për të adresuar plotësisht rekomandimet tona në pikat e mësipërme 1-5, ka shkaktuar që të kemi gjetje të ngjashme në këto katër fusha të cilat mbeten për t'u adresuar si në të ardhmen.

IV. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

IV.1 Hyrje

Ne kuptuam dhe vlerësuam veprimet e ndërmarra nga menaxhimi për të siguruar menaxhimin efektiv dhe kontrollin financiar. Për sistemet financiare individuale ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin kontrollet aktuale veprojnë. Ky mund të jete, për shembull aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhimi i lartë ose kontrollet operative në nivele të ulëta. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të projektuar mirë, nëse janë zbatuar siç është planifikuar dhe nëse veprojnë në mënyrë efektive.

IV.2 Planifikimi dhe realizimi buxhetor

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të ardhurave të grumbulluara. Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Vështrim i përgjithshëm mbi buxhetin dhe shpenzimet aktuale në mijë EUR

| Përshkrimi | Buxheti Fillestar | Buxheti Final | 2012 Realizimi | 2011 Realizimi | 2010 Realizimi |
|--|-------------------|---------------|----------------|----------------|----------------|
| Granti Qeveritar | 4,865 | 5,065 | 4,975 | 4,936 | 3,950 |
| Të barturat nga viti paraparak | | 120 | 97 | - | - |
| Të hyrat vetanake | 593 | 593 | 275 | 592 | 432 |
| Donacionet e vendit | | 2 | - | - | - |
| Donacionet e jashtme | | 134 | 90 | 65 | 22 |
| I. Totali i te ardhurave dhe transferimeve nga donacionet | 5,458 | 5,914 | 5,437 | 5,593 | 4,404 |
| Pagat dhe Mëditjet | 3,762 | 3,771 | 3,728 | 3,557 | 2,769 |
| Mallra dhe shërbime | 402 | 521 | 511 | 433 | 454 |
| Shpenzimet komunale | 84 | 165 | 164 | 87 | 87 |
| Subvencionet dhe transferet | 30 | 47 | 39 | 73 | 61 |
| Investimet Kapitale | 1,180 | 1,410 | 995 | 1,443 | 1,033 |
| Rezervat | - | - | - | - | - |
| II. Gjithsej pagesa | 5,458 | 5,914 | 5,437 | 5,593 | 4,404 |
| Ndryshimi I-II | - | - | - | - | - |

Konkluzioni

Pranimet aktuale totale ishin më të ulëta se buxheti final për 477 mijë Euro, e cila kryesisht është si rezultat i realizimit më të ulët të të hyrave vetanake për 341 mijë, granteve qeveritare 90 mijë Euro dhe granteve dhe donacioneve për 46 mijë Euro.

Pagesat totale ishin më të ulëta se buxheti final për 477 mijë Euro për shkak të pagave dhe mëditjeve më të ulëta për 43 mijë Euro, mallrave dhe shërbimve më të ulëta për 10 mijë Euro, shërbimet komunale më të ulëta për 1 mijë Euro, transfereve dhe subvencioneve më të ulëta për 8 mijë Euro dhe shpenzimeve kapitale më të ulëta për 415 mijë Euro.

Buxheti fillestar ishte më i ulët për 456 mijë Euro se buxheti final për shkak, si në vijim: alokime shtesë nga granti qeveritar për 200 mijë Euro, të hyrave vetanake të bartura prej 120 mijë Euro dhe granteve dhe donacioneve për 136 mijë Euro nuk ishin parashikuar në buxhetin fillestar. Të gjitha ndryshimet nga buxheti origjinal janë aprovuar mbi rishikimin e buxhetit, bazuar në Vendim të Qeverisë së Kosovës apo të aprovuara nga Kryetari ose Kuvendi Komunal. Këto ndryshime janë të mbështetura gjithashtu nga vendimet e kuvendit dhe të mandatuara nga korniza ligjore Ligji 03/L-048.

Buxheti i pashpenzuar i Komunës në vitin 2012 është 8.1%.

IV.3 Raportimit aktual dhe afatet kohore në procesin e përgjithshëm buxhetor

Përmbushja e detyrimeve aktuale të raportimit të jashtëm, si dhe procesi i tij buxhetor:

- Kërkesat buxhetore u realizuan në kohën e duhur;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare për nëntë mujorin janë dorëzuar në kohën e duhur në MF;
- Draft plani i prokurimit është dorëzuar në kohë në MF;
- Plani i Veprimit për rekomandimet zbatuese është përfshirë në pasqyrat vjetore financiare të Komunës.

Të Gjeturat

Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuara.

IV.4 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të Gjeturat

Gjatë testimeve tona kemi vënë re :

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për të hyrat nga tatimi në prone. Komuna nuk mban regjistra të faturimit për llojet e tjera të të ardhurave. Në vend të kësaj, janë regjistruar vetëm arkëtimet me para të gatshme nga të hyrat e tilla.
- *Mbledhja e të hyrave:* Përveç tatimit mbi pronën, leje biznesi dhe ndërtimi, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normën e saktë të mbledhjes ose të ndjek në kohë mbledhjen e të hyrave vetanake

- *Harmonizimi i të hyrave.* Komuna nuk ka bërë ndonjë barazim formal të të hyrave të mbledhura me departamentin e kontabilitetit përgjatë vitit 2012.
- *Dobësitë e sistemit të automatizuar të faturimit.* Sistemi i faturimit të tatimit në pronë është i centralizuar dhe Komuna ka qasje të kufizuar në sistem. Kufizime të tilla kufizojnë aftësinë e Komunës për të gjeneruar raporte të rregullta dhe gjithëpërfshirëse për mbledhjen e të ardhurave dhe arkëtimet e lidhura, dhe si rezultat dëmtojnë aftësinë e saj për të monitoruar siç duhet dhe për të shqyrtuar mbledhjet e tilla. Edhe pse raportet e tilla janë të gjeneruara automatikisht nga sistemi me bazë të centralizuar, Komuna nuk i përdor ato në mënyrë të rregullt. Për më tepër, lista e mbledhjeve për vitin e gjeneruar nga sistemi për tatimin mbi pronë nuk është pajtuar dhe nuk pajtohet me mbledhjet e regjistruara në Free Balance.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, efeciente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do të mundësonte menaxhimin të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurohet që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet.

Ne i rekomandojmë Komunës të konsiderojë pikat si në vijim:

- Implementimin e një sistemi faturimi që përfshin detaje të përditësuara për paguesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pagues. Qasje në informacione të tilla duhet të jetë e limituar për vetëm një numër personash dhe me autorizimin e menaxhimit.
- Të vendosë dhe të kontrollojë në mënyrë qendrore tarifat dhe normat e taksave të aprovuar në sistem, që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Të ekzistojë lidhje në mënyrë automatike midis sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që të dhënat në librin kryesor të procesohen në mënyrë automatike.
- Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta ndërmjet tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh transaksionesh.

IV.5 Shpenzimet

5.1 Prokurimet

Të gjeturat

Gjatë inspektimit tonë të dokumenteve për zgjedhjen tone të dosjeve të prokurimit ne kemi vërejtur disa mospërputhje me procedurat që kërkohen nga Ligjin i Prokurimit Publik 04/L-042. Këto devijime janë përshkruar më poshtë:

- Gjashtë dosje të prokurimit ku përfshihen dosjet me nr. KA652/12/002/136, KA652/12/27/521, KA652/12/011/136, KA652/12/021/236, KA652/11/32/521 dhe KA652/11/27/521: me shumë totale të kontraktuar prej 336 mijë Euro dhe vlerë totale të paguar deri në fund të vitit 2012 prej 299 mijë Euro, janë nën hetime nga zyra e prokurorit publik dhe nuk na janë dhënë neve. Ne nuk jemi në dijeni për arsyet dhe statusin e atyre hetimeve, si dhe për rezultatin e mundshëm final.
- Në prokurimet me nr. KA652/12/040/521; KA652/12/34/121 dhe KA652/12/67/136, deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve nuk është nënshkruar nga zyrtarët autorizues, ku përfshihen Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor Administrativ.
- Në prokurimin nr. KA652/12/58/521, përfituesi i tenderit nuk kishte kontrata të mëhershme dhe referenca të mjaftueshme .

- Në prokurimin nr. KA652/11/006/521, plani dinamik që do duhej të jipte informacion për periudhën kohore për përfundimin e projektit dhe të kalkulonte ditët nuk gjendej ne dosjen e fituesit të tenderit.
- Në prokurimin nr. KA652/12/45/521 ishin shkaktuar vonesat të kryerjes së punëve sipas planit dinamik, për shkak të kapaciteteve të ulëta dhe një numrit të pamjaftueshëm të punëtorëve të autoritetit të kontraktuar. Komuna nuk ka zbatuar ndëshkime për këto vonesa, siç parashihej me kontratë.
- Në prokurimin nr. KA652/12/58/521, vlera e kontratës ishte më e lartë se kostoja e parallogaritur në ofertën fituese për 643 Euro.
- Në prokurimin nr. KA652/12/34/121, edhe pse kriteret e kërkuara nuk përmbusheshin nga pjesëmarrësit në tender, tenderi nuk ishte shpallur për ritenderim. Fituesi nuk i ka dorëzuar Komunes listën e kërkuar të pajisjeve dhe dokumentet mbështetëse për ato pajisje.
- Në prokurimin nr. KA652/12/45/521, dosja e fituesit nuk përmban dokumentet e kërkuara, si : dokumentet dëshmuese për pronësinë e pajisjeve, dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për stafin dhe qarkullime bankare të pamjaftueshme..
- Ne prokurimin nr. KA652/12/43/121 dhe KA652/12/45/521, shuma e kontraktuar ishte paguar tërësisht edhe pse bazuar në raportin e pranimit, kualiteti i punëve të kryera ishte i dobët.
- Shuma prej 750 Euro ishte paraqitur si shpenzime kapitale, në vend se të regjistrohej si transfer për financim të ngjarjeve kulturore, sic tregohet nga natyra e atyre shpenzimeve.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarre hapa të mëtijshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

5.2 Shpenzime të tjera

Gjetje

Çështjet e mëposhtme janë vënë re sa i përket shpenzimit prej 24 mijë Euro, që paraqet pagesë për projektin “Ndërtimi i qendrës për komunitete”, një projekt i bashkë financuar në mes të Komunës, “Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF)” dhe komisionit “Komisioni i Projektit Kacaniku i Vjetër (CP)”:

- Kontrata në mes të CDF dhe CP nuk ishte nënshkruar nga CP;
- CDF ka organizuar procedurat e prokurimit dhe Komuna nuk ka dëshmi të procedurave të tilla, për të mbështetur pagesën;
- Pagesa është bazuar në kërkesën e CDF dhe faturën e CDF pa dokumente të tjera mbështetëse;
- Nuk është gjetur vendimi për emërimin e përfaqësuesit të Komunës në komisionin vlerësues të tenderëve.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarre hapa të mëtijshëm për marrjen dhe paraqitjen e grupeve të plota të dokumentacionit të kërkuar për shpenzime të tjera.

5.3 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Gjetjet

Tri dosje të personelit të rishikuara nga ne, nuk përmbanin dokumente, si: formulari i aplikimit të punëtorit dhe raporti i vlerësimit të performancës, dokumentet e identifikimit, dhe dëshmi që stafi nuk është nën hetime. Këto dosje janë dosje të punëtorëve të punësuar nga Komuna në vitet e kaluara.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna mirëmban dosjet e personelit me të gjitha dokumentet e kërkuara nga rregulloret përkatëse.

5.4 Subvencionet dhe transferet

Gjetjet

Nuk kemi identifikuar përjashtime të mëdha.

IV.6 Asetet

6.1 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Gjetjet

Nuk kemi identifikuar përjashtime të mëdha.

6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Gjetjet

Komuna nuk ka një proces të mirëfilltë planifikimi për identifikimin, evidentimin dhe ndjekjen e faturave të lëshuara për taksat e saj. Bazuar në vrojtimin tonë të dokumentave, shumë nga të arkëtueshmet që janë shpalosur në pasqyrat financiare, janë në lidhje me vitet e mëparshme. Komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të mbledhur këto shuma dhe nuk ka mbajtur raport të vjetërsisë së tyre. Për shembull të arkëtueshmet në sistemin qendror për tatimin në pronë nuk pajtohen me të arkëtueshmet për tatimet e tilla të shpalosur në Shënimin 34 në pasqyrave financiare.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se janë dizajnuar dhe krijuar procese, të cilat sigurojnë që të arkëtueshmet regjistrohen mbi leshimin e çdo fature dhe që shumat në vonese ndiqen në mënyrë të rregullt.

6.3 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjetjet

Çështjet e mëposhtme janë vënë re sa i përket shpalosjes së pasurive kapitale jo-financiare në vlerat mbi 1,000 Eur në posedim të organizatës buxhetore në Shënimin 30 të pasqyrave financiare:

- Kemi vënë re diferencë në vlerë prej 80 mijë Euro në mes të pasurisë kapitale totale të shpalosur në Shënimin 30 “Përmbledhja e asetëve kapitale jo-financiare (me vlerë mbi 1,000 Euro) nën posedim të organizatës buxhetore” dhe regjistrin të pronës që na është dhënë nga Komuna.
- Edhe pse Komuna ka përgatitur dhe shpalosur një listë të plotë të pasurisë së patundshme në Shënimin 30, për pasuritë të caktuara, mund të ketë paqartësi në lidhje me të drejtat e pronësive në mes të Komunës dhe Agjensive të ndryshme të tjera të Qeverisë së Kosovës, dhe mungesë të mbështetjes të dokumentacionit të pronësisë.
- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, ndertesave dhe pajisjeve duke përfshirë informatat si data e blerjes dhe asgjësimin e pasurive dhe zhvlerësimi për vitin.
- Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës për matjen e një pjese të konsiderueshme të pronës, ndertesave dhe pajisjeve, shpalosur në Shënimin 30, Komuna ka kërkuar të mase të tilla objekte në vlerën e drejtë në bazë të një vlerësimi të kryer nga një komitet i themeluar i brendshëm. Komisioni nuk është i përbërë nga ekspertë vlerësues dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë të përkrahura nga raporte vlerësimi. Vlerësimi përfshinte vetëm ndërtesat kryesore komunale dhe jo të gjitha pronat, ndërtesat dhe pajisjet ishin përfshirë.
- Komuna nuk ka përgatitur një shtojcë që do të shpaloste pasuritë kapitale jo-financiare të detajuara, me vlerë mbi 1,000 Euro të përmbledhura në shënimin 30. Një shtojcë e tillë kërkohet në shabllonin e Pasqyrave Financiare të përgatitur në përputhje me Rregullën Financiare 07/2011.
- Komuna nuk ka përgatitur një shtojcë që do të shpaloste pasuritë kapitale jo-financiare të detajuara, me vlerë nën 1,000 Euro të përmbledhura në shënimin 31. Një shtojcë e tillë kërkohet në shabllonin e Pasqyrave Financiare të përgatitur në përputhje me Rregullën Financiare 07/2011.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë që Kryetari të përfshijë burime shtese në regjistrimin, kontrollimin dhe vlerësimin e asetëve të Komunes.

IV.7 Trajtimi i borxheve

Gjetjet

Çështjet e mëposhtme janë vërejtur sa i përket detyrimeve të papaguara, të shpalosura në Shenimin 28 të pasqyrave financiare:

- Në përputhshmeri me Ligjin LMFPP 03/L-048, Neni 39.1, organizata buxhetore është përgjegjëse që të sigurohet se cdo fature e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të pranuar dhe/ose punëve të kryera për organizatën buxhetore paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës apo kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore . Në kemi vërejtur 68 raste ku pagesa nuk është bërë brenda afatit prej 30 ditësh, sic kërkohet nga Ligji Nr. 03/L-048, Neni 39.1. Shuma e faturave të tilla është 11,000 Euro ; dhe
- Kemi vërejtur se një pagesë është bërë në vitin 2013 për një faturë në vlerë prej 20,457 Euro e lëshuar në vitin 2012, faturë e cila nuk është përfshirë në shpalosjen e faturave të papaguara.

V. Sistemi i Auditimit të brendshëm

V.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm

V.2 Auditimi i Brendshëm

Gjetjet

Puna e Auditimit të Brendshëm u fokusua në vitet e mëparshme, në vend se në periudhën aktuale.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë që Kryetari duhet të bëjë një Plan Veprimi që duhet zbatohet për të siguruar që puna e auditimit të brendshëm është bërë dhe raportuar mbi një bazë kohore dhe për të adresuar rekomandimet e rezultuara, detajon oficerët përgjegjës dhe afatin kohor për zbatim

VI. Konkluzioni i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Komunës së Kaçanikut

Perfundime te pergjithshme

Siç u diskutua në këtë raport, përmirësime duhet të bëhen në fushat e të hyrave, të prokurimit, të kompenzimit, trajtimit të të arkëtueshmeve, pagimi i detyrimeve brenda afatit të kërkuar, vlerësimi dhe barazimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale.

Rekomandimi i pergjithshëm

- Pasqyrat financiare duhet te pregatiten ne përputhshmëri me Udhëzimet Administrative aktuale dhe me SNKSP;
- Një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave duhet të formohet, duhet të kryhen barazimet në mes të zyrtarit të Hyrave Vetanake dhe departamenteve operationale, si dhe duhet të ndermirren masa që të rriten inkasimet(mbledhjet) nga taksat e ndryshme; dhe
- Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për përmirësimin e procedurave të shpenzimeve dhe prokurimit.
- Një listë gjithpërfshirëse e pronës, impianteve dhe pajisjeve, duke përfshirë pagesat prej palëve të treta,mbahet dhe rishikohet.
- Përpilimi i një Plan Veprimi që duhet të zbatohen për të siguruar që puna e auditimit të brendshëm është bërë dhe raportuar mbi një bazë kohore dhe për të adresuar rekomandimet e rezultuara, detajon oficerët përgjegjës dhe afatin kohor për zbatimin

Shtojcë 1 Lloje te ndryshme të Opinioneve te Auditimit te zbatuara nga KPMG ne Raportin Vjetor te Audtimit 2012

(e shkeputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion auditimi normalisht është një format standard, qe lidhet me pasqyrat financiare ne tërësi, duke shmangur keshtu nevojën shpallur gjeresisht cfare qendron prapa tij por duke por duke bartur sipas natyrës së tij një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të tij. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore e auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregojë qartë nese eshte pa rezerve, me rezerve dhe nese është rasti i ketij te fundit, nëse është me rezerve ne aspekte te caktuara apo eshte opinion kunder (paragrafi 14), apo është refuzim (paragrafi 15).

10. **Një opinion pa rezerve** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke perdorur baza dhe politika kontabel të pranueshme të cilat janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme;
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat vendase dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; dhe
- d) ka shpalosje te pershtatshme të të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksimi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mund të konsiderojë se lexuesi nuk do të kuptojë sic duhet pasqyrat financiare vec nese terhiqet vemendja per çështje të pazakonta apo të rëndësishme. Ne parim te përgjithshem, auditori kur jep një opinion të pa rezerve nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion me rezerve. Per te shmangur kete përshtypje, referencat që janë menduar si “theksime te çështjeve” gjenden në paragrafe të ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdore theksimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternative zëvendësimi opinionin me rezerve.

12. Auditori mund të **mos jetë në gjendje të shprehe një opinion pa rezerva** kur ekziston ndonje prej rrethanave në vijim, dhe në gjykimin e auditorëve, efekti i tyre është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

- a) ka pasur kufizime në qellimin e auditimit;
- b) auditori konsideron që pasqyrat nuk janë te plota apo jane çorientuese apo ekziston një largim i pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

ekzistojnë pasiguri që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionin me rezerve.** Kur auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurve në lidhje me një ose me tepër zera të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo thelbesore për kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion me rezerve. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar per një pasqyrim të qartë dhe konciz, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të pasigurive që cojne ne nje opinion me rezerve. Efekti i pasigurise apo mospajtimit i dhene ne menyre sasiore nga auditorit ndihmon përdoruesit e pasqyrave, megjithese kjo nuk eshte gjithmone praktike apo relevante.

14. **Opinionin kunder.** Kur auditori nuk ka mundësi të formojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi për shkak të mosmarrëveshjeve që janë aq thelbësore sa pozicioni i prezantuar ne nje opinion me rezerva ne disa aspekte te pasqyrave financiare nuk eshte i pershtatshem, leshohet opinion kunder. Formulimi i një opinionin të tillë e bent e qarte qe pasqyrat financiare nuk jane te shplalosura ne menyre te drejte, duke specifikuar qartesisht dhe ne menyre te permbledhur te gjitha ceshtjet e mosmarrveshjeve. Serish, eshte ndihmuese nese vendoset ne menyre sasiore efekti financiar kur kjo eshte relevante dhe praktike.

15. **Refuzimi per opinion.** Aty ku auditori e ka te pamundur te arrije nje nje opinion per pasqyrat financiare ne teresi per shkak te nje pasigurie apo kufizimi ne qellim qe eshte aq thelbesor saqe nje opinion me rezerva ne disa aspekte nuk eshte i pershtatshem, leshohet refuzim per opinion. Formulimi i ketij refuzimi e ben te qarte

qe nuk mund te jepet nje opinion duke specifikuar qarte dhe ne menyre te permbledhur te gjitha ceshtjet e pasigurive.

16. Zakonisht SAI ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethanat në të cilat është e pamundur të jepet një opinion pa rezerva.

Shtojcë 2: Rekomandimet nga viti paraprak

| Komponenta e Auditimit | Rekomandimi ose gjetja | Rekomandimet plotësisht të implementuara | Pjesërisht të adresuar | Të pa adresuara |
|------------------------|--|--|------------------------|-----------------|
| IV.4 Të hyrat | <ul style="list-style-type: none"> • <i>Sistemi i faturimit.</i> Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për të hyrat nga tatimi në prone. Komuna nuk mban regjistra të faturimit për llojet e tjera të të ardhurave. Në vend të kësaj vetëm arkëtimet me para të gatshme nga të hyrat e tilla janë regjistruar. • <i>Mbledhja e të hyrave:</i> Përveç tatimit mbi pronën, leje biznesi dhe taksa në pronat me qera, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normën e saktë të mbledhjes ose të përcjellë mbledhjen e të hyrave vetanake në baza kohore. • <i>Dobësitë në sistemin automatik të faturimit.</i> Sistemi I automatizuar I tatimit në pronë është I centralizuar dhe komuna nuk mund të rishikoj dhe të mbikqyrë mbledhjen e të hyrave, meqenëse kjo bëhet automatikisht nga sistemi. | | | Të pa adresuara |

| Komponenta e Auditimit | Rekomandimi ose gjetja | Rekomandimet plotësisht të implementuara | Pjesërisht të adresuar | Të pa adresuara |
|--|---|--|-------------------------|-----------------|
| VI.3 Shpenzimet | Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kerkesat e rregulloreve lokale. | | | Të pa adresuara |
| VI 5 Pasuritë 5.2. Trajtimi I të arkëtueshmeve | <p>Ne i rekomandojmë Kryetarit të vendosë një process i cili siguron që të arkëtueshmet janë regjistruar sapo të jëtë bërë faturimi. Gjithashtu, regjistri i të arkëtueshmeve duhet të perditësohet sipas pagesave të bëra në lidhje me këto të arkëtueshme. Kjo do t'i mundësojë Komunës të përgatisë dhe planifikojë një buxhet më të besueshëm.</p> <p>Për më tepër, ne i rekomandojmë Komunës që të rishikoj trajtimin e limitit të pranimin të parasë së gatshme.</p> <p>Gjithashtu, ne i rekomandojme Komunës që të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme mbledhjen e të arkëtueshmeve.</p> | | | Të pa adresuara |
| VI 5 Pasuritë 5.3 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale | Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të certifikuar është rekomanduar si praktika më e mirë në raste të tilla. Megjithate, komuna duhet te kete parasysh nje analize te koston krahasuar me benefitet e perfshirjes se eksperteve vleresues perpara se ti angazhoje ata. | | Të adresuara pjesërisht | |
| VI 5 Pasuritë 5.4 Trajtimi I borxheve | Rekomandojme qe Kryetari te marre masa qe Komuna te forcoje kontrollet e te veproje ne perputhje me ligjet dhe rregulloret per shpenzimet dhe dhe pagesat e tyre. | | | Të padresuara |

Shtojcë 3 Komentet e Menaxhmentit të Komunës së Kaçanikut dhe përgjigjja e KPMG-së

| Rekomandimet | Pajtohemi | Pajtohemi pjesërisht | Nuk pajtohemi | Komentet e Komunës | Komentet e KPMG-së |
|--|-----------|----------------------|---------------|---|--------------------|
| <p><u>Rekomandimi 1:</u> Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunes të sigurohet se përgatitja e pasqyrave financiare duhet të përfshijë procedura dhe mjete të dizajnuara për sigurimin që informatat e kërkuara janë të regjistruara, të procesuara, të përmbledhura dhe të raportuara në mënyrë të përshtatshme në pasqyra financiare.</p> | | X | | <ul style="list-style-type: none"> • Neni 16 – Të shënim 30 diferenca prej Eur 80,877 si mosbarazim është si pasojë e vonësave të shprehura nga komisionet të cilat kanë përllogaritur amortizimin grupor e jo individual. • Të Neni 13 – Realizimi i THVK dhe donacionet e paraqitura të Pasqyra e realizimit të buxhetit (shënim 15 dhe 16): këtu kemi të bëjmë me inkasimin (vjeljen) e të hyrave brenda vitit raportues dhe të dhënat janë të bazuara nga SIMFK, para datës 31.01.2013. | |

| Rekomandimet | Pajtohemi | Pajtohemi pjesërisht | Nuk pajtohemi | Komentet e Komunës | Komentet e KPMG-së |
|--|----------------------------|----------------------|---------------|--|--------------------|
| <p>Rekomandimi 2: Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, efeciente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do ti mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurohet që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet.</p> <p>Ne i rekomandojmë Komunës të konsiderojë pikat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Implementimin e një sistemi faturimi që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pages. Qasje në informacione të tilla duhet të jetë e limituar për vetëm një numër të personave dhe duhet të jenë të autorizuar nga menaxhmenti. • Të vendosë dhe të kontrollojë tarifatat dhe normat e taksave në sistem në mënyre qendrore, që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet. • Të ekzistojë lidhje në mënyrë automatike midis sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyre që të dhënat në librin kryesor të procesohen në mënyre automatike. | <p>X</p> <p>X</p> <p>X</p> | <p>X</p> <p>X</p> | | <p>Sistemi i aplikueshëm ekzistues në nivel të vendit - SIMFK-ja, nuk na e mundëson teknikisht operacionet dhe një lidhshmëri të tillë. Mendojmë se ky rekomandim është gabimisht i adresuar te komunat, sepse lidhur me këtë mangësi MF-ja është kompetente dhe nën autoritetin e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk kemi ndonjë program të autorizuar nga MF-ja i cili kishte me eliminuar njëherë e përgjithmonë këtë parregullësi. SIMFK-ja na mundëson vetëm evidentimin e të hyrave të depozituara përmes bankave komerciale, respektivisht BQK-së. • Nga pamundësia e pajisjes me ndonjë program enkas, komuna është duke shqyrtuar mundësinë që në një periudhë të afërt të themelojë një zyre të posaçme (zyre kryesore) ku do të krijoheshin të gjitha parakushtet për lëshimin e të gjitha faturave nga një qendër për të gjitha shërbimet duke u bërë edhe regjistrimi i të gjitha pagesave, qoftë në të gatshme (arkës) apo bankës. Me këtë do të krijonim evidenca të mirëfillta dhe të besueshme në të gjitha realacionet debitore-kreditore me të gjithë taksapaguesit dhe partneret e komunës. | |

| Rekomandimet | Pajtohemi | Pajtohemi pjesërisht | Nuk pajtohemi | Komentet e Komunës | Komentet e KPMG-së |
|--|-----------|----------------------|---------------|--|--------------------|
| <p><u>Rekomandimi 2 (vazhdim):</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta ndërmjet tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh transaksionesh. | X | | | <ul style="list-style-type: none"> Nga pamundësia e SIMFK-së dhe mungesa e një programi adekuat e të lejuar nga MF-ja, evidencat alternative në Exel, menaxhmentit nuk i sigurojnë besueshmëri të plotë. <p>Përsërisim se këto operacione direkte dhe të besueshme të faturimi dhe lidhja automatike me shërbimet tjera si në evidencë ashtu edhe të barazimi, janë si pasojë e mungesës së një programi adekuat nga MF-ja apo nga Komuna, i cili do të kishte edhe koston e vet. Ky problem është paraqitur vazhdimisht nga ne, por edhe nga komunat tjera, por deri më tani kemi hezituar në furnizimin e saj pa autorizim nga MF-ja.</p> | |
| <p><u>Rekomandimi 3 dhe 4:</u></p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kerkesat e rregulloreve lokale.</p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshëm për marrjen dhe paraqitjen e grupeve të plota të dokumentacionit të kërkuar për shpenzime të tjera.</p> | | X | | <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i plotë i LMFPF, LPP, KBF, akteve tjera nga lëmia e financave publike. Prokurimi (6) UZP-të e marrura nga Policia | |
| | | | | | |

| Rekomandimet | Pajtohemi | Pajtohemi pjesërisht | Nuk pajtohemi | Komentet e Komunës | Komentet e KPMG-së |
|---|------------------|-----------------------------|----------------------|--|---------------------------|
